

VENDIM
Nr.600, datë 18.8.2011

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMET: NR.1699, DATË 29.12.2008; NR.707, DATË 23.6.2009; NR.784, DATË 1.7.2009; NR.1147, DATË 25.11.2009; NR.1231, DATË 11.12.2009; NR.1259, DATË 23.12.2009; NR.268, DATË 21.4.2010; NR.382, DATË 19.5.2010; NR.714, DATË 25.8.2010; NR.1015, DATË 10.12.2010; NR.1069, DATË 29.12.2010; NR.61, DATË 26.1.2011; NR.135, DATË 23.2.2011; NR.196, DATË 9.3.2011; NR.297, DATË 14.4.2011; NR.363, DATË 4.5.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E DËMSPËRBLIMIT FINANCIAR PËR ISH-TË DËNUARIT POLITIKË TË REGJIMIT KOMUNIST”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 9 e 10, të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimet: nr.1699, datë 29.12.2008; nr.707, datë 23.6.2009; nr.784, datë 1.7.2009; nr.1147, datë 25.11.2009; nr.1231, datë 11.12.2009; nr.1259, datë 23.12.2009; nr.268, datë 21.4.2010; nr.382, datë 19.5.2010; nr.714, datë 25.8.2010; nr.1015, datë 10.12.2010; nr.1069, datë 29.12.2010; nr.61, datë 26.1.2011; nr.135, datë 23.2.2011; nr.196, datë 9.3.2011; nr.297, datë 14.4.2011; nr.363, datë 4.5.2011, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e dëmshpërblimit financiar për ish-të dënuarit politikë të regjimit komunist”, bëhen korrigjimet e gabimeve me karakter material në të dhënat që përmbajnë numrin e dosjes dhe të gjenealiteteve të ish-të dënuarve politikë që kanë përfituar dëmshpërblim financiar nëpërmjet këtyre akteve, sipas aneksit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha